

Kontrate Shitje Kuotash

Mbajtur ne Tirane, sot ne date 24/08/2018, midis dy paleve te meposhtme:

1. SHITESI: Z. Andrew Progri, mbajtes i pasaportes kanadeze Nr. HN200730, i datelindjes 04 Gusht 1961, ne cilesine e zoteruesit te 1 (nje) koute prej 91% (nentedhjete e nje perqind) te kapitalit themeltar te regjistruar te Shoqerise "Stevensville Engineering" shpk me NUIS L81521037L, referuar me poshte ne kete kontrate si **SHITESI**;

dhe

2. BLERESI: Zj. Mimoza Progri, shtetas shqiptar, mbajtes i kartes se identitetit nr. G362250360, i datelindjes 25 Dhjetor 1963, referuar me poshte ne kete kontrate si **BLERESI**.

Palet e mesiperme, me vullnet te plote e te lire, kane rene dakord per lidhjen e kesaj Kontrate Shitje Kuotash me kushtet e meposhtme:

TE DHENA BAZE

Z. Andrew Progri, zoterues i nje koute qe perfaqeson 91% (Nentedhjete e Nje Perqind) te kapitalit themeltar te Shoqerise "Stevensville Engineering" shpk, shoqeri e se drejtes shqiptare e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NUIS L81521037L dhe adrese ne Tirane, Vaqarr, Rruga e Arbanes, Zona Kadastrale 3712, Nr. Pasurie 14/5.

Z. Andrew Progri, me ane te kesaj kontrate shitblerje, synon te transferoje plotesisht kuoten ne zoterimin e tij tek Zj. Mimoza Progri. Palet me vullnet te plote dhe te lire kane rene dakord per kete transferim kuotash te kapitalit themeltar, per te cilin eshte mare dhe vendimi i asamblese se ortakeve te shoqerise e cila miraton shitjen e kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "Stevensville Engineering" shpk tek Zj. Mimoza Progri.

NENI 1


OBJEKTI I KONTRATES

1.1 Shitja nga Shitesi tek Bleresi i nje kuote qe perfaqeson 91% (nentedhjete e nje perqind) te kapitalit themeltar te regjistruar te Shoqerise "Stevensville Engineering" shpk si dhe cdo lloj te drejte reale, personale si dhe interes pasuror te lidhur me kete kuote dhe kapitalit themeltar qe kuota perfaqeson, te drejta keto qe mund te vijne tani ose ne te ardhmen, duke njohur bleresin si te vetmin pronar ligjor te tyre.

1.2 Blerja prej Bleresit nga Shitesi i nje kuote qe perfaqeson 91% (nentedhjete e nje perqind) te kapitalit themeltar te regjistruar te Shoqerise "Stevensville Engineering" shpk si dhe cdo lloj te drejte reale, personale si dhe interes pasuror te lidhur me kete kuote dhe kapitalit themeltar qe kuota perfaqeson, te drejta keto qe mund te vijne tani ose ne te ardhmen, duke njohur bleresin si te vetmin pronar ligjor te tyre.

NENI 2

CMIMI - MENYRA E PAGESES



Cmimi i shitjes se kesaj kuote qe perfaqeson 91% (nentedhjete e nje perqind) te kapitalit themeltar te regjistruar te Shoqersie "Stevensville Engineering" shpk eshte **1,00 Lek (nje lek)**. Pagesa e blerjes se kesaj kuote eshte 1,00 Lek (nje lek) dhe do behet Cash.

NENI 3

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITESIT SI DHE DEKLARATA E GARANCISE

Shitesi deklaron dhe garanton bleresin qe:

1. Eshte pronar i vetem i kesaj quote qe perfaqeson 91% (nentedhjete e nje perqind) te kapitalit themeltar te regjistruar te shoqerise "Stevensville Engineering" shpk dhe gezon te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe jane te lidhura me to;
2. Shitesi garanton se eshte i vetmi titullar i ligjshem i kuotes qe po transferohet nepermjet kesaj kontrate, e cila eshte e lira nga cdo barre apo pretendim tjetër ligjor.
3. Shitesi nuk eshte pale, as nuk eshte ne dijeni te ndonje rreziku per ndjekje gjyqesore, arbitrazhi apo administrative, rezultati i te ciles mund te kishte efekt material negativ per shitjen e kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise.

NENI 4

TRANSFERIMI I TITULLIT TE KUOTAVE

Pronesia e kesaj kuote, qe perfaqeson 91% (nentedhjete e nje perqind) te kapitalit themeltar te regjistruar te shoqerise "Stevensville Engineering" shpk, transferohet nga shitesi tek bleresi menjehere me lidhjen dhe nenshkrimin e kesaj kontrate.

NENI 5

Baza Ligjore

Baza ligjore e kesaj kontrate shitblerje bazohet ne ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", statutin e shoqerise "Stevensville Engineering" shpk dhe kodin civil te Republikes se Shqiperise, dispozitat mbi shitjen.

NENI 6

ZGJIDHJA E MOSMARVESHJVE


Ne rast konflikti palet do te mundohen ti zgjidhin ato me mirekuptim, ne rast te kundert palet mund t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo Kontrate hartohet ne 4 (kater) kopje origjinale te njenjta ne gjuhen shqipe, te cilat jane hartuar me vullnet te plote e te lire te shitesit dhe bleresit.

PALET

SHITESI

Z. Andrew Progni



BLERESI

Zj. Mimoza Progni

